

VENDIM
Nr.145, datë 11.2.2009

PËR TRANSFERIMIN E PAKETËS SË AKSIONEVE TË ZOTËRUARA NGA SHTETI
NË “ALBTELECOM”, SHA, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 9 e 13 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë” dhe të neneve 1 e 2, pika 4, të ligjit nr.8810, datë 17.5.2001 “Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime “Albtelecom””, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin e paketës së aksioneve të zotëruara nga shteti, prej 16.7683661 për qindësh, të “Albtelecom”, sh.a.-së, Tiranë, nëpërmjet ankandit.

2. Ky transferim të realizohet me asistencën e një shoqërie këshilluese ndërkombëtare.

3. Shpenzimet, në vlerën 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, për zhvillimin e procedurave të përzgjedhjes së konsulentit, për shërbimet, që do të kryejë konsulenti, si dhe për shpenzime të tjera, të nevojshme për realizimin e transferimit të paketës, të mbulohen nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, deri në përfundim të procesit të shitjes.

4. Pas përfundimit të procesit të shitjes, Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës t’i rimbursohen shpenzimet e përmendura në pikën 3 të këtij vendimi, nga të ardhurat e realizuara nga shitja e paketës së aksioneve shtetërore, sipas raportit financiar, të paraqitur nga kjo ministri.

5. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha